



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË SH.A
DREJTORIA E PROKURIMEVE
SEKTORI I INVESTIMEVE DHE PROJEKTEVE



Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ___/___/2019

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: Operatorin Ekonomik “B-VAAL ENGINEERING” sh.p.k me NIPT L72023002P, me seli në Adresën: Tirane, Paskuqan, Lagjja Paskuqan 1, rruga Demokracia, ndertesa nr.1, pranë Ahmati Petrol.

Lloji i procedurës se prokurimit: “Kërkesë për Propozim”

Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër: Mbikqyrja e punimeve të ndërtimeve dhe rikonstruksioneve të rrjetit të Ujësjiellës Kanalizimeve për UKT sh.a. (Faza V)”

2.1 Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-00462-12-20-2018

Numri i referencës së procedurës/lotit 1 REF-00467-12-20-2018

Fondi limit në total: 4.268.676 (katër milion e dyqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

Loti i Parë: “Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Instalimi i sistemit ujëmatës në burimet e ujësjiellësit të Tiranës”, me fond limit 746.530 (shtatëqind e dyzet e gjashtë mijë e pesëqind e tridhjetë) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:

Për Lotin e parë afati: Nga momenti i lidhjes së kontratës së sipërrmarjes për zbatimin e punimeve deri në përfundimin e punimeve (afati 3 muaj).

Burimi i financimit: Të ardhurat e SH.A Ujësjiellës-Kanalizime, Tiranë.

Data e zhvillimit të tenderit është: 04.01.2019 Ora: 09:00

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 51 datë 24.12.2018

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik “Novatech Studio” shpk NIPT-i L01717030C
Vlera: 689,105(gjashtëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e pesë)lekë pa tvsh.

2. Operatori ekonomik “Studio Services K-SA”sh.p.k NIPT-i L71305518R
Vlera: 690,220(gjashtëqind e nëntëdhjetë mijë e dyqind e njëzetë)lekë pa tvsh.

3. Operatori Ekonomik “REAN 95” sh.p.k NIPT-i J61827043V

Vlera: 716.000(shtatëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë)lekë pa tvsh

4. Operatori Ekonomik “GB Civil Engineering” sh.p.k NIPT-i L51825011V
Vlera: 693,207(gjashtëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e dyqind e shtatë)lekë pa tvsh.

5. Operatori Ekonomik “B-VAAL Engineering” sh.p.k NIPT-i L72023002P

Vlera: 653,584,8(gjashtëqind e pesëdhjetë e tre e tetëqind e tetëdhjetë e katër presje tetë)lekë pa tvsh.

6. Operatori Ekonomik “A&E Engineering” sh.p.k NIPT-i K72113010E
Vlera: 720.000(shtatëqind e njëzetë mijë)lekë pa tvsh

Të skualifikuar:

1. Oferta e paraqitur nga Operatori Ekonomik “Novatech Studio” Sh.P.K

Çmimi total i ofertës: 689,105(gjashtëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e pesë)lekë pa tvsh.

Afati: Nga momenti i lidhjes së kontratës së sipërrmarjes për zbatimin e punimeve deri në përfundimin e punimeve 90 (ditë).

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 53 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar), dhe të Kreut VII Nenit 66 pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë vijon:

Së pari AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit pika 4 si më poshtëcitur:

4.Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, librezat e punës, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit stafi inxhinierik si më poshtë:

-1(një) inxhinier Mjedis (i pajisur me çertifikatë lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis)

Operatori ekonomik “Novatech Studio”sh.p.k nuk ka arritur të dëshmojë se ka pjesë të stafit teknik

1(një inxh.mjedisi) çka bie në kundërshtim me kriterin e kërkuar në DST.

Konkretisht gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në sistemin elektronik të paraqitur nga operatori ekonomik “Novatech Studio”sh.p.k KVO vëren se në përmbushje të kriterit të kërkuar në DST operatori ekonomik ka paraqitur kontratë pune,datë 29.03.2018,nr.rep 2003,nr.kol 1777, me znj.Elena Gliozheni shoqëruar me çertifikatën e ndikimit në mjedis,cv,diplomën përkatëse ,librezën e punës.

Nga verifikimi i diplomës i znj.E.G.i KVO vëren se titulli i saj është Arkitekte,Fakulteti i Inxhinierisë.

Sqarojmë operatorin ekonomik se nuk jeni skualifikuar për shkak se çertifikata e ndikimit në mjedis e paraqitur nga ana juaj i është lëshuar znj.E.G me profesion arkitekte por për shkak se nuk keni arritur të paraqesni dokumentacion për të dëshmuar se dispononi pjesë të stafit teknik 1(një inxh.mjedisi).

Ne rregullat e prokurimit publik theksohet se , operoret jane te detyruar te pergatitin ofertat dhe paraqesin te plote te gjitha dokumentacionin e kerkuar ne DT .

Mopletesimi qofte edhe i nje kriteri te vetem perben shkak per skualifikim .

Në shtojcën 7 shprehimisht parashikohet se.... Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Gjithashtu sqarojmë se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DST

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII,Neni 66 pika 3, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2.” Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “**Studio Services K-SA**”sh.p.k

Çmimi total i ofertës: 690,220(gjashtëqind e nëntëdhjetë mijë e dyqind e njëzetë)lekë pa tvsh.

Afati:Nga momenti i lidhjes së kontratës së sipërrmarjes për zbatimin e punimeve deri në përfundimin e punimeve 90 (ditë).

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 53 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar), dhe të Kreut VII Neni 66 pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë vijon:

Së pari AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit pika 4 si më poshtëcitur:

4.Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, librezat e punës, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit stafi inxhinierik si më poshtë:

- një) inxhinierë Ndërtimi

- 1(një) inxhinier Hidroteknik
- 1(një) inxhinier Mjedis (i pajisur me çertifikatë lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis)

Në përmbushje të kriterit të kërkuar në DST konstatohet se operatori ekonomik Studio Services KSA ka paraqitur në sistemin elektronik stafin e tij teknik si më poshtë vijon:

- 1.z.Sh. S.me profesion (inxh.elektrik)
2. z.B. S. me profesion (inxh.hidroteknik) i pajisur me çertifikatë e ndikimit në mjedis
- 3.P. S. me profesion(inxh.mekanik)

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik KVO vëren se operatori ekonomik nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion për të dëshmuar se ka pjesë të stafit teknik 1(një) inxhinier ndërtimi dhe 1(një)inxhinier mjedisi çka bie në kundërshtim me kriterin e kërkuar në DST.

Në këto kushte KVO është e detyruar të zbatojë nenin 55/2 të parashikuar në ligjin nr.9643,datë 20.11.2006”Për Prokurimin Publik”në të cilën shprehimisht parashikohet se....

Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.

Gjithashtu vlen të theksojmë se nëse operatori ekonomik do të kishte pretendime nbi vendosjen e këtij kriteri apo paqartësi ka pasur momentin procedural për të paraqitur ankesë pranë AK brenda afateve të përcaktuara në legjislacionin për prokurimet publike.

Në këto kushte kur operatori ekonomik nuk ka ezauruar momentet procedurale për të kundërshtuar kriteret e vendosura ka qënë i detyruar që në fazën e vlerësimit të ofertave të paraqesë dokumentacionin e kërkuar në DST.

Ne rregullat prokurimit publik theksohet se , operatorët janë të detyruar të përgatitin ofertat dhe paraqesin të plote të gjithë dokumentacionin e kërkuar në DT .

Moplotësimi qofte edhe i nje kriteri te vetem perben shkak per skualifikim .

Në shtojcën 7 shprehimisht parashikohet se.... Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Gjithashtu sqarojmë se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DST

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII,Neni 66 pika 3, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

3. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “**REAN-95**” **SH.P.K** me ofertë 716.000(shtatëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë)lekë pa tvsh

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 53 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar), dhe të Kreut VII Neni 66 pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe

dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë vijon:

Së pari AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit kapaciteti teknik pika 3.3.1 si më poshtë cituar:

1.Operatori ekonomik duhet të ketë realizuar shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë prej 40 % e vlerës së fondit limit ose në vlerën prej 298.612 (dyqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e dymbëdhjetë) Lekë pa TVSH, të realizuara gjatë tre viteve të fundit, datë e përlogaritur nga data e hapjes së ofertave.

- Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar me vërtetimin e realizimit të leshuar nga institucioni.

- Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat përkatëse tatimore të shitjes ku të shenohen datat, dhe të jete i specifikuar shërbimi i kryer.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik operatori ekonomik REAN-95 sh.p.k ka paraqitur kontratat me objekt Mbikëqyrje Punimesh”Kanali Ujitës Kodër Lekel”datë 06.04.2017 prot 51/2 ref me vlerë 148,400 (njëqind e dyzetë e tetë mijë e katërqind)lekë pa tvsh kontratën shtesë me objekt” Mbikëqyrje Punimesh”Kanali Ujitës Kodër Lekel”me vlerë 29,680(njëzetë e nëntë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë)lekë pa tvsh shoqëruar me vërtetimin e realizimit .

Gjithashtu operatori ekonomik ka paraqitur në sistemin elektronik kontratën me objekt”Rikonstruksioni i Linjave të Ujësjellësit në Rrugët e e Qytetit të Elbasanit viti 2016”datë 14.10.2016 me vlerë 120.000(njëqind e njëzetë mijë)lekë pa tvsh me palë Shoqërinë Ujësjellës Kanalizime Elbasan.

KVO vëren se kontrata e nënshkruar me palë Shoqërinë Ujësjellës Kanalizime Elbasan i mungon vërtetimi i realizimit të shoqëruar nga institucioni përkatës dhe për rrjedhojë mungesa e dokumentacionit të kërkuar në DST do të konsiderohet i paplotë dhe për rrjedhojë i pavlefshëm.

Theksojmë se pavarësisht se operatori ekonomik Rean 95 sh.p.k ka paraqitur në sistemin elektronik 2 kontrata nënshkruar me Bashkinë e Tepelenës shoqëruar me vërtetimin e realizimit KVO vëren se vlera totale e kontratave është 178,080(njëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e tetëdhjetë)lekë pa tvsh duke mos plotësuar vlerën prej 298.612 (dyqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e dymbëdhjetë) Lekë pa TVSH,të përcaktuar në DST.

Përsa më sipër dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik Rean 95 sh.p.k do të konsiderohet i paplotë dhe për rrjedhojë i pavlefshëm.

Në rregullat prokurimit publik theksohet se , operatorët janë të detyruar të përgatitin ofertat dhe paraqesin të plote të gjithë dokumentacionin e kërkuar në DT .

Moplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vetëm përben shkak për skualifikim .

Në shtojcën 7 shprehimisht parashikohet se.... Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Gjithashtu sqarojmë se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DST

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të

Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin ekonomik, “B-VAAL ENGINEERING” SH.P.K me NIPT L72023002P, me administrator Z.Valter Begaj, me vlerë të ofertës: 653,584,8 (gjashtëqind e pesëdhjetë e tre e tetëqind e tetëdhjetë e katër presje tetë) lekë pa tvsh, **se është identifikuar si oferta e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a me adresë rruga “5 Maji” pranë Medresesë, Tiranë, me nr tel: +355 4 2225572, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 08.01.2019

Ankesa: Nuk ka patur.

